



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:209486
Datë: 24.09.2024
Numri i dokumentit: 06201803

K.Dh.Shk.II.nr.1565/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike - konfliktin administrativ sipas propozuesit – paditësit Kolegji N...B..“U...” , SH.P.K. me NUI ..., me seli në Prishtinë, të cilin sipas e përfaqëson A.T., kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, me seli në Lipjan, për shkak të shtyrjes së vendimit të Nr. 01-462/01-26915 të datës 31.05.2024, i nxjerr nga Komisioni i Ankesave të Komunës së Lipjanit, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit – paditësit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për çështje administrative K.A.nr.358/24, të datës 26.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e propozuesit – paditësit Kolegji N...B..“U...”, SH.P.K me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative K.A.nr. 358/24, të datës 26.07.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, është vendosur si ne vijim:

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, në Aktvendimin e ankimuar ka vendosur si në vijim:

“REFUZOHET në tërësi kërkesa e paditësit Kolegji N...B..“U...”, SH.P.K, me seli në Prishtinë, me NUI:... me të cilën ka kërkuar shtyrje të njoftimit publik për dhënie në shfrytëzim afatgjate të pronës së paluajtshme Nr.prot.01-462/01-26915 të datës 31.05.2024 sipas vendimit nr.01-463/01-27603 të datës 14.06.2024 të komisionit të Ankesave të Komunës së Lipjanit, derisa Gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor lidhur me padinë e paditësit.”

Kundër këtij Aktvendimi, ka ushtruar ankesë propozuesi, me pretendime për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që të aprovet si e bazuar ankesa e paditëses dhe aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative ta anuloj.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar pala kundër propozuese.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e ankimuar, e ka refuzuar kërkesën e paditësit/propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, me arsyetimin se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit, përkatësisht nuk është vërtetuar se cili është dëmi konkret dhe si është i matshëm ky dëm që i shkaktohet paditësit, dhe i cili dëm vështirë do të riparohej me ekzekutimin e vendimit kontestues. Gjykata në shkallë të

parë po ashtu vlerësoi se për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 22 par. 2 të LKA-së. Po ashtu ka cek se paditësi i referohet një palujshmërie tjetër që nuk është objekt sipas vendimit të kundërshtuar, respektivisht i referohet pronës në sipërfaqe prej 3,5 ha të cilën paditësi e ka në shfrytëzim afatëgjatë patundshmërinë në të cilën ka ndërtuar Kampusin Universitar, e cila gjendet në fqinjësi të patundshmërisë/parcelës kontestuese me numër P-...., e cila është objekt i vendimit të kundërshtuar nr. 01-463/01-27603 të datës 14.06.2024 të Komisionit të Ankesave dhe njoftimit publik për dhënje në shfrytëzim afatëgjatë të pronës së paluajtshme nr. 01-462/01-26915 të datës 31.05.2024, pra është e pa sqaruar nëse paditësi do të pësonte dëm të drejtëpërdrejtë nga ekzekutimi i vendimit të kundërshtuar dhe njoftimit publik për dhënje në shfrytëzim afatëgjatë të pronës së paluajtshme me numër P-...., apo se i njëjti do të pësonte dëm të tërthortë ashtu që dëmi i shkaktohet në pronën që aktualisht e ka në shfrytëzim afatëgjatë ku ushtron aktivitetin e cila gjendet në fqinjësi të patundshmërisë kontestuese, sepse paditësi vetëm i referohet faktit se e ka në shfrytëzim pronën në fqinjësi pa dhënë asnjë pretendim se si ndërlidhet kjo me dëmin që e pëson nga paluajtshmëria kontestuese. Ka theksuar se paditësi nuk e ka bërë të besueshëm pretendimin dhe nuk e ka bazuar në asnjë provë se me ekzekutimin e vendimit të kundërshtuar dhe me ekzekutimin e njoftimit publik për dhënje në shfrytëzim afatëgjatë të pronës së paluajtshme 01-462/01-26915 datës 31.05.2024 të njëjtit i shkaktohet dëm vështirë i pariparueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka cek se plotësimi i kushtit të parë i përcaktuar në nenin 22 par 2 të LKA-së, se ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohet është i pabazuar sepse nuk është argumentuar mjaftueshëm dhe nuk është mbështetur në prova, gjykata vlerëson se vlerësimi nëse janë plotësuar kushti i dytë që shtyrja të mos jetë në kundërshtim me interesin publik dhe kushti i tretë që shtyrja nuk do të sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar, është jo relevante, sepse të gjitha kushtet duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe nuk mjafton vetëm plotësimin e një apo dy kushteve.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 dhe 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse

ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Edhe kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë njëjtë si gjykata e shkallës së parë vlerëson se shtyrja e ekzekutimit të vendimit paditësit nuk do t'i sillte dëm i cili vështirë do të riparohej si dhe nuk është argumentuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, kushte këto të përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Pretendimet ankimore të palës paditësi/propozuese, të cekura si më lartë, dhe të shtjelluara si në arsyetim të ankesës për shkeljet e pretenduara nga gjykata e shkallës së parë, kolegji i vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme për vendosjen e kësaj çështje në mënyrë tjetër, sepse nuk dëshmohet se aktvendimi i goditur është i nxjerrë me shkelje të dispozitave të procedurës siç pretendon e paditura në ankesë. Ngase edhe vlerësimi i kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 dhe 6 të LKA-së. Sepse, kërkesa tërësisht është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe pretendimet me të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë për Departamenti Administrativ, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së propozuesit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit. Meqë në këtë rast paditësi, nuk ka bërë të besueshme pretendimet se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit duke ju referuar dispozitave ligjore, të nenit 22 par.2 të LKA-së. Prandaj, pretendimet ankimore janë të paqëndrueshme sepse nga provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës nuk e arsyetojnë shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ në këtë rast, ngase nuk dëshmojnë se pa shtyrjen e vendimit kontestues do të shkaktonte dëm të pariparushëm apo se ekziston rreziku i shkaktimit të dëmit apo humbjeve të

tjera, andaj edhe kolegji i kësaj gjykate gjenë se paditësi-propozuesi me prova të cilat ja ka bashkangjit kërkesës në fjalë nuk janë bindëse dhe nuk e mbështetin pretendimet e paditësit-propozuesit se ekziston mundësia e shkaktimit të dëmit apo humbje të tilla, andaj, kolegji i kësaj gjykate erdh në përfundim se propozuesi-paditësi kërkesën për shtyrje të ekzekutimit nuk e ka bërë të besushëm me prova bindëse dhe konkrete, që me ekzekutimin e vendimit kontestues do të mund të shkaktohet ndonjë dëm të riparuarshëm, e cila do të mund të riparohej me vështërsi.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoj të gjitha pretendimet ankimore por gjeti se të njëjtat nuk kanë ndikim ndryshe në vendosje lidhur më këtë rast, andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr. 1565/24, me datë 23.09.2024

Kryetarja e kolegjit-Gjyqtarja

Franciska Zhitija Ymeri